

1254/1  
22.10.2018



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS**

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", nr. 1, Tiranë; Tel-Fax: 0694057089  
E-mail: [rmuca@klsh.org.al](mailto:rmuca@klsh.org.al); Web-site: [www.klsh.org.al](http://www.klsh.org.al)


Nr. Prot. 750/7

Tiranë, më 18/10/2018

Miratohet

**KRYETAR**

**PROGRAM AUDITIMI PERFORMANCE**



**CILËSIA DHE TARIFIMI I SHËRBIMEVE STUDENTORE  
PRANË IAL-ve PUBLIKE**

*Konfidenciale: Ky dokument është pronësi e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Ai përmban informacion konfidencial dhe qëllimi i tij është gjenerimi i përgjigjeve zyrtare dhe administrative gjatë fazës së terrenit të auditimit nga ana e subjekteve të përfshira në auditim.*



Departamenti i Performancës në KLSH

@Performanca

## PËRMBAJTJA

1. RËNDËSIA E AUDITIMIT.....	4
1.1. KONTEKSTI I PROBLEMIT SOCIAL DHE TË PERFORMANCËS.....	5
1.2. STRATEGJIA E KLSH-SË NË AUDITIMET E PERFORMANCËS. ....	6
1.3. AUDITIME TË MËPARSHME NË KËTË FUSHË .....	7
1.4. SUBJEKTET NËN AUDITIM.....	8
1.4.1 HYRJE .....	10
1.4.2 Politikat e Institucioneve .....	12
1.4.3 Pesha në buxhet dhe GDP .....	13
1.4.4 Risqet e aktivitetit të subjektit.....	14
1.4.5 Rëndësia e produkteve të subjektit. ....	16
1.4.6 <i>Feedback</i> -u i subjektit në fazën studimore .....	17
2.1. OBJEKTIVI DHE PROBLEMI I PERFORMANCËS.....	19
2.1.1 Fokusimi dhe përkufizimi i problemit të performancës.....	19
2.1.2 Objektivi i auditimit .....	19
2.2. PËRKUFIZIMET DHE TERMINOLOGJIA .....	19
2.3. KRITERET.....	21
2.3.1 Kriteret e politikës.....	21
2.3.2 Kriteret e monitorimit dhe raportimit .....	21
2.3.3 Kriteret teknike.....	21
2.3.4 Kriteria të tjera/Praktikat më të mira .....	24
2.4. PIRAMIDA E PYETJEVE AUDITUESE .....	28
2.5. SKEMA E AUDITIMIT .....	29
2.5.1 Qasja/ Metodologjia audituese.....	29
2.5.2 Metodatat & teknikat audituese.....	29
2.6. REZULTATET E PARASHIKUARA .....	29
2.6.1 Impakti i mesazhit auditues për Kuvendin dhe Qeverinë.....	30
2.6.2 Impakti i mesazhit auditues për publikun dhe palët e interesit.....	30
2.6.3 Forma e publikimit.....	30
3. KALENDARI DHE KOSTO E AUDITIMIT.....	31
3.1. MATRICA E ORGANIZIMIT .....	31
3.2. KOSTO E AUDITIMIT .....	32
3.3. MATRICA E KRYERJES SË AUDITIMIT SIPAS KOHËS DHE SUBJEKTEVE .....	32
3.4. MATRICA E MARKIMIT TË PIRAMIDËS SË PYETJEVE .....	32
4. RISQET E AUDITIMIT DHE GARANTIMI I CILËSISË .....	32
4.1. RISQET E AUDITIMIT .....	32
4.2. GARANTIMI I CILËSISË.....	33
5. GRUPI I PUNËS DHE PËRGJEGJËSITË HIERARKIKE .....	33

✂ LISTA E SHKURTIMEVE

AKFAL	Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë
AKKSHI	Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit
ASCAL	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë
BA	Bordi i Administrimit
DIND	Diplomat për Programet e Integruara të Nivelit të Dytë
ENQA	Rrjeti European i Sigurimit të Cilësisë
EQAR	Regjistri European i Sigurimit të Cilësisë
HEAL	Stadard i BE për Sigurimin e Cilësisë për Arsimin e Lartë
IAL	Institucion i Arsimit të Lartë
ISHA	Inspektoriati Shtetëror i Arsimit
IZHA	Instituti i Zhvillimit të Arsimit
KALKSH	Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor
LAL	Ligji i Arsimit të Lartë
MASR	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
QSHA	Qendra e Shërbimeve Arsimore
RASH	Rrjeti Akademik Shqiptar
UAMD	Universiteti "Aleksander Moisiu" Durrës
UBT	Universiteti Bujqësor i Tiranës
UFSNK	Universiteti " Fan S. Noli" Korçë
UIQV	Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë
ULGSH	Universiteti " Luigj Gurakuqi" Shkodër
UMT	Universiteti Mjekësisë, Tiranë
UT	Universiteti i Tiranës

## 1. RËNDËSIA E AUDITIMIT

Auditimi është një pjesë thelbësore e procesit të llogaridhënies për shpenzimin e parave publike, duke dhënë kështu një kontribut të rëndësishëm për miradministrimin e burimeve dhe kryerjen e shërbimeve për qytetarët. Nëpërmjet auditimit të performancës bëhet një ekzaminim i pavarur për të kuptuar nëse angazhimet qeveritare, operacionet, programet, aktivitetet apo institucionet e saj janë duke vepruar në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efijencës dhe efektivitetit dhe nëse ka vend për përmirësim, në aktivitetin e tyre. Kontrolli i Lartë i Shtetit auditon midis të tjerave veprimtarinë ekonomiko-financiare të institucioneve shtetërore e të personave të tjerë juridikë publikë, për të evidentuar nëse aktiviteti i tyre ka rezultuar me efektivitet, efijencë dhe ekonomicitet, duke rekomanduar masat e duhura për përmirësimin e performancës së tyre. Veç këtyre, nëpërmjet auditimit, KLSH bën transparente përdorimin e fondeve publike, administrimin e pronës publike dhe burimeve natyrore kombëtare, kryerjen në kohë, me cilësi dhe kosto optimale të shërbimeve publike, etj.<sup>1</sup> Kryerja e auditimeve në përgjithësi dhe atyre të performancës në veçanti nga KLSH bëhet në përputhje të plotë me standardet INTOSAI dhe me objektivat e Strategjisë për Zhvillim të EUROSAI 2011-2017, të cilat gjejnë pasqyrim në Strategjinë e Zhvillimit të KLSH 2018-2022. Sipas kësaj Strategjie, KLSH ka për objektiv rritjen e cilësisë së auditimit dhe shtimin e numrit të auditimeve të performancës, nëpërmjet audituesve të përgatitur dhe të mirë-trajnuar. Tematika e auditimeve të performancës nis me përzgjedhjen e propozimeve për auditim që në vitin paraardhës, në zbatim të Manualit të Auditimit të Departamentit të Performancës, i miratuar me urdhrin e Kryetarit të KLSH-së nr.47, datë 30.4.2015<sup>2</sup>.

Problematikat që shërbyen si indicie për fillimin e një auditimi me këtë tematikë, ishte raporti i organizatës "Qëndresa Qytetare" mbi autonominë dhe menaxhimin financiar të universiteteve publike në Shqipëri, raport i realizuar me mbështetjen e Fondacionit Friedrich Ebert. KLSH ka kryer dhe më parë auditim në fushën e arsimit të lartë për shkak të rëndësisë dhe impaktit që kjo fushë ka në publik. Hyrja në fuqi e ligjit për arsimin e lartë bashkë me reflektimet e amendimeve që ky ligj mbart, solli nevojën e një auditimi të ri në sistemin arsimin të lartë, për të vlerësuar implementimin e tij përsa i përket autonomisë financiare, organizative dhe të kërkimit shkencor që ky ligj i njeh IAL-ve publike dhe sa të afta janë këto institucione të arsimit të lartë për të përfituar nga kjo autonomi e atribuar nga ligji dhe çfarë përmirësimi është reflektuar në shërbimet që ato ofrojnë kundrejt studentëve.

Arsimi i lartë në Shqipëri është një shërbim dhe e mirë publike dhe, si i tillë, shteti duhet t'i kushtojë vëmendje të posaçme, të rrisë ndjeshëm kontributin e tij, për të mundësuar shërbime më cilësore për studentët duke i përmirësuar shërbimet ekzistuese, si dhe të rrisë numrin e shërbimeve të ofruara, duke garantuar cilësi dhe standarde konkurruese me ato të vendeve të zhvilluara europiane.

Arsimi i lartë duhet t'iu përgjigjet, t'iu përshtatet dhe t'iu paraprijë ndryshimeve në tregun e punës dhe në zhvillimin e vendit. Qëllimi i reformës në arsim ishte krijimi i një arsimit të lartë cilësor, për t'iu përgjigjur nevojave të tregut të punës, si dhe drejtimeve të zhvillimit strategjik të vendit, krijimi i mekanizmave të qëndrueshëm të brendshëm

<sup>1</sup> Neni 6 i Ligjit 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".


<sup>2</sup> Manuali i Auditimit të Performancës.

dhe të jashtëm të kontrollit, për të siguruar standarde europiane në sistemin e arsimit të lartë, njësimi dhe standardizimi i sistemit arsimor, vendosja e arsimit të lartë mbi baza financiare të qëndrueshme si dhe autonomia institucionale e IAL-ve. Kryerja e auditimeve në arsimin e lartë si dhe vlerësimi i ligjit, akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, implementimit dhe funksionimit të sistemit arsimor në tërësi, ka si qëllim rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit të IAL-ve publike në ofrimin e shërbimeve studentore dhe arritjen e misionit të tyre.

### 1.1. KONTEKSTI I PROBLEMIT SOCIAL DHE TË PERFORMANCËS

Sipas parashikimeve të Ligjit për Arsimin e Lartë<sup>3</sup>, IAL-të publike vendosin tarifat e shkollimit duke respektuar kufirin maksimal të përcaktuar me vendim të këshillit të ministrave<sup>4</sup> dhe me pas janë bordet e administrimit të IAL-ve që miratojnë tarifat e shkollimit dhe shërbimeve për studentët pas vendimit të marrë nga senati akademik. Vendimi i Këshillit të Ministrave përcakton kufirin maksimal të tarifës së shkollimit për programet e studimit të ciklit të parë dhe ato të ciklit të dytë të integruar në institucionet publike të arsimit të lartë, pas propozimit të ministrisë përgjegjëse për arsimin. Të ardhurat që përfitohen nga tarifat e shkollimit, regjistrimit, konkurrimit dhe të shërbimeve të tjera studentore përbëjnë një të ardhur të rëndësishme për procesin mësimor, akademik, shkencor dhe administrativ të IAL-ve publike. Nga të dhënat paraprake që grupi auditues mbledhi gjatë fazës studimore pranë IAL-ve subjekt auditimi, të ardhurat dytësore të përfituara kryesisht nga tarifat e shkollimit dhe të shërbimeve ndaj studentëve, variojnë në diapazonin 27-51% kundrejt buxhetit total<sup>5</sup> të IAL-ve.

Skema nr.1. Tregues të ndryshëm për Arsimin e Lartë



Burimi: MASR; Perpunimi Grupi i KLSH

<sup>3</sup> Neni 7 pika "P" e Ligjit 80/2015 mbi Arsimin e Lartë

<sup>4</sup> VKM Nr.288, date 21.05.18...përcaktimi i kufirit maksimal të studimit në IAL-të publike

<sup>5</sup> Buxheti total IAL-ve perbehet nga Fondi I MASR dhe te ardhurat dytesore te krijuara nga vete IAL-të

Nga përpunimi i të dhënave paraprake të mbledhura gjatë kësaj faze, rezulton se IAL-të publike përveç UT, sigurojnë të ardhurat dytësore nga tarifat e studimit më të vogla se granti i mësimdhënies të akorduara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në varësi të masës së të ardhurave dytësore që sigurojnë IAL-të përcaktohet numri i anëtarëve përfaqësues të IAL-ve në bordin e administrimit<sup>6</sup>. Si rezultat i këtij përcaktimi ligjor, UT është i vetmi institucion i arsimit të lartë publik që ka katër anëtarë përfaqësues në bordin e administrimit të zgjedhur nga trupa akademike e tij, kundrejt tre anëtarëve përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin.

Grupi auditues e ka pasqyruar raportin e të ardhurave dytësore me grantin për mësimdhënie në tabelën nr.1 të seksionit "Pesha në Buxhet e Subjekteve në Auditim". Buxheti i IAL-ve përbëhet nga granti për mësimdhënie i akorduar nga ministria përgjegjëse për arsimin, masa dhe skema e financimit përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave<sup>7</sup> dhe nga të ardhurat dytësore që sigurojnë vetë IAL-të. Aktualisht IAL-të publike vazhdojnë të ofrojnë të njëjtat shërbime studentore që janë ofruar dhe vitet e mëparshme

Studenti gjatë procesit të pranimit në IAL-të publike paguan:

- Tarifë aplikimi për program studimi pranë QSHA;
- Tarifë regjistrimi pranë IAL-së;
- Tarifë shkollimi pranë IAL-së.

Më pas në IAL-të publike, studentët paguajnë tarifa shërbimi, si:

- a) Tarifa për Master Profesional;
- b) Tarifa për Master Shkencor;
- c) Tarifa për Doktoraturë / Specializim;
- d) Tarifa për Programin të dytë Studimi;
- e) Tarifa për Diplomën;
- f) Tarifa për Vërtetim Studenti;
- g) Tarifa për Konkurse;
- h) ... etj.

## **1.2. STRATEGJIA E KLSH-SË NË AUDITIMET E PERFORMANCËS.**

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në kuadër të objektivave të përcaktuara në Planin Strategjik të Zhvillimit 2018-2022, në zbatim të standardeve ndërkombëtare të auditimit (INTOSAI dhe EUROSAI), dhe në zbatim të funksionit të tij kushtetues, kryen krahas llojeve të tjera të auditimit dhe auditimit të performancës<sup>8</sup>. KLSH e ka përcaktuar si një ndër sfidat kryesore të tij përmirësimin e cilësisë dhe shtimin e numrit të auditimeve të performancës. Tashmë KLSH i kryen auditimet e performancës në bazë të Manualit të Departamentit të Performancës, Udhëzuesit dhe Indikatorëve të Performancës, të cilat konsiderohen si dokumente dinamike, që përditësohen me progresin praktik. "Auditimi i performancës" ka të bëjë me auditimin e ekonomicitetit, efijencës dhe efektivitetit dhe përfshin:

- a) auditimin e ekonomicitetit, që nënkupton minimizimin e kostos së burimeve që përdoren në një veprimtari publike, duke mos cenuar cilësinë e tij.
- b) auditimin e efijencës, që nënkupton optimizimin e raportit burime-produkte të

<sup>6</sup> Neni 48 pika "2" e Ligjit 80/2015 mbi Arsimin e Lartë

<sup>7</sup> VKM nr.75 datë 12.02.2018 "Për miratimin e modelit të financimit të IAL-ve publike"

<sup>8</sup> Neni 13 i Ligjit 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

veprimtarisë publike, duke modifikuar proceset, strukturat dhe gjithë zinxhirin ekonomik të vlerës, në përputhje me standardet kombëtare e ndërkombëtare dhe praktikatat më të mira.

c) auditimin e efektivitetit, që nënkupton vlerësimin e përputhjes së produktit me objektivat e paravendosura dhe plotësimin e nevojave të taksapaguesve, në përputhje me politikatat e subjektit të audituar.<sup>9</sup>

Kontrolli i Lartë i Shtetit, nëpërmjet realizimit të auditimeve të performancës, jep një informacion shumë më të gjerë dhe të thelluar mbi ecurinë e të gjithë projekteve, programeve dhe shërbimeve që kryhen në entet publike të audituara. KLSH, gjatë dhe pas procesit auditues, këshillon dhe ndihmon drejtuesit, stafin dhe personelin e enteve publike për përmirësimin e proceseve të punës, sidomos aty ku eficientia është e vështirë për t'u matur, duke i nxitur dhe orientuar drejt nevojave të qytetarëve.

### 1.3. AUDITIME TË MËPARSHME NË KËTË FUSHË

Një nga objektivat kryesore të arsimit të lartë është transformimi i shoqërisë drejt zhvillimit të qëndrueshëm. Sigurimi i cilësisë është mekanizëm thelbësor për zhvillim të qëndrueshëm dhe një faktor i rëndësishëm në promovimin dhe ruajtjen e besimit të publikut për arsimin e lartë.

Rritja e cilësisë së shërbimeve të ofruara ndaj studentëve përbën avantazhin e IAL-ve në shfrytëzimin e autonomisë që garanton ligji i arsimit të lartë. Shërbimet studentore përbëjnë një nga aktivitetet më të qenësishme për sistemin e arsimit të lartë, dhe si të tilla kanë nevojë dhe domosdoshmëri të vlerësohen në aspekt të eficientës dhe efektivitetit që ato ofrojnë.

KLSH ka kryer dhe më parë auditime performance në ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe në disa IAL publike në vend me fokus: "Kurrikulat universitare dhe avancimi në karrierën akademike" dhe "Performanca e procesit të pranimeve në IAL publike nëpërmjet Maturës Shtetërore 2016". Në këto Institucione, të cilat janë përgjegjëse për arsimin e lartë, KLSH ka kryer vazhdimisht edhe auditime të natyrës financiare dhe ligjshmërisë, duke evidentuar çështje të një natyre të ndryshme nga ajo për të cilën interesohet ky auditim performance. Në mënyrë të përmbledhur mesazhi kryesor për auditimin e performancës së pranimit në IAL publike nëpërmjet Maturës Shtetërore 2016 ishte:

---

*Modeli i pranimit që u aplikua në vitin 2016 dhe po përpiqet të implementohet sërish, nuk është ai i duhuri, si në konceptim, ashtu edhe në aplikim. Ky model nuk është në përputhje me frymën e Ligjit 80/2015 dhe as me praktikatat e mira të vendeve perëndimore prej nga ky Ligj është përshtatur.*

*MAS dhe QSHA duhet të angazhohen aktivisht në procesin e aplikimit, duke e nisur më herët atë në kohë, asistuar aplikantët dhe IAL-të në kërkesat e tyre për mbarëvajtjen e duhur të procesit kundrejt tarifave të arsyeshme dhe kryerjen e procesit të regjistrimit të fituesve pa interferuar me procesin e pranimit, por në fund të tij, mbështetur në listat përfundimtare të dërguara nga IAL-të.*

*IAL-të duhet ta konceptojnë, dizenojnë dhe implementojnë vetë procesin e pranimit, në përputhje me Ligjin dhe praktikatat e mira. Kriteret e tyre e të pranimit duhet të reflektojnë*

---

<sup>9</sup> Manuali i Departamentit të Auditimit të Performancës.


*një politikë afatgjatë të tyre, që t'i mundësojë aplikantëve profilizimin potencial në arsimin e mesëm, sikurse nuk duhet të kufizohen vetëm në përlllogaritjen e mesatareve, por mund të përfshijnë edhe aspekte të tjera të vlerësimit të kandidatëve, sidomos për programet e preferuara të studimit.*

#### 1.4. SUBJEKTET NËN AUDITIM

“Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë” është ministria e linjës përgjegjëse për sistemin arsimor shqiptar. Struktura organizative e MASR-së përmban dy drejtori të përgjithshme: Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Drejtorinë e Përgjithshme Rregullore dhe Përputhshmërisë për Arsimin, Sportin dhe Rininë. Pjesë e strukturës së MASR-së, janë dhe Drejtoria e Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Derregullimit, Lejeve, Liçensave dhe Monitorimit, Drejtoria e Programit, Standartizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, Drejtoria e Integritit, Koordinimit Marrëveshjes dhe Asistencës, Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, Drejtoria e Konçesioneve, Prokurimeve dhe Partneriteteve si edhe Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar.

Në skemën Nr. 1 është paraqitur marrëdhënia e subjekteve nën auditim që janë të përfshira në sistemin e arsimit të lartë. IAL-të janë institucione të cilat ndërveprojnë me MASR mbi bazën e LAL. Institucionet e Arsimit të Lartë publik bashkëveprojnë me RASH në bazë të marrëveshjeve të bashkëpunimit në fushën e shërbimeve studentore me mjete të teknologjisë së informacionit. Kryesisht IAL-të kanë marrëveshje për shërbimet e sekretarive elektronike mësimore në fushën e administrimit të proces verbaleve të provimeve dhe të regjistrit elektronik të vlerësimeve nëpërmjet programit ESSE 3.

Skema nr.2. Subjektet nën auditim



Burimi: Grupi i auditimit të KLSH

Universiteti i Tiranës është institucioni arsimor publik më i madh në vend. Aktualisht, në Universitetin e Tiranës studiojnë 28.394 studentë. Qëllimi i UT është ndërtimi dhe konsolidimi i një shoqërie demokratike dhe të shtetit ligjor me anë të zhvillimit të një sistemi arsimor, shkencor, kulturor dhe ekonomik në shërbim të një shoqërie bazuar në



rritjen e mirëqenies dhe respektimit të dinjitetit njerëzor.

Fakultetet pjesë e Universitetit të Tiranës janë:

- Fakulteti i Ekonomisë;
- Fakulteti i Drejtësisë;
- Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë;
- Fakulteti i Shkencave Natyrore;
- Fakulteti i Gjuhëve të Huaja;
- Fakulteti i Shkencave Sociale.

*Universiteti i Mjekësisë, Tiranë* është qendra më e madhe universitare publike e mësimdhënies në fushën e arsimit të lartë në shkencat mjekësore. Aktualisht në këtë Universitet studiojnë 7.427 studentë.

Universiteti i Mjekësisë ka në strukturën e tij tre fakultete:

- Fakulteti i Mjekësisë;
- Fakulteti i Mjekësisë Dentare;
- Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike.

Objektivi i Universitetit është edukimi i studentëve konform standardeve më të larta profesionale dhe shkencore, për përmbushjen e misionit të tyre në shërbim të pacientit për parandalimin dhe trajtimin e sëmundjeve.

*Universiteti Bujqësor, Tiranë* ka në vizion edukimin profesional dhe kërkimin shkencor në fushat e përcaktuara. Misioni i UBT-së lidhet me formimin bujqësor në drejtim të zhvillimit të bujqësisë moderne dhe garantimit të ushqimit të shëndetshëm dhe cilësor. Arritja e këtij objektivi madhor fokusohet në prodhimin e nevojshëm dhe shpërndarjen e produkteve bujqësore e blegtorale, cilësinë e lartë të produkteve, menaxhimin e kujdesshëm të tokës, ujit, ajrit dhe përdorimin e harmonizuar të funksioneve të hapësirës së blertë dhe të kaltër.

Universiteti ka në përbërjen e tij gjashtë fakultete:

- Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit;
- Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit;
- Fakulteti Bioteknologjisë dhe Ushqimit;
- Fakulteti i Shkencave Pyjore;
- Fakulteti i Mjekësisë Veterinare;
- Instituti i Resurseve Gjenetike të Bimëve.

*Universiteti "Fan S. Noli" Korçë* është një institucion arsimor dhe shkencor që ofron një shumëllojshmëri programesh studimi në ciklin e lartë arsimor. Aktualisht në këtë Universitet studiojnë 4.500 studentë.

Universiteti ka në përbërjen e tij katër fakultete:

- Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane;
- Fakulteti i Ekonomisë;
- Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë;
- Fakulteti i Bujqësisë.

Universiteti "Fan S. Noli", synon respektimin e lirisë së shkencës dhe vlerave europiane, të kontribuojë në fushën e kërkimit shkencor, didaktikën dhe aktivitetet e drejtuara për të ndjekur një dituri të hapur në përputhje të plotë me dinjitetin human.

*Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë* është themeluar më 10 tetor 1994 dhe ka për mision kërkimin, studimin dhe formimin shkencor të studentëve, duke garantuar mundësi të barabarta dhe respektim të dinjitetit human, transparencë dhe pluralizëm të ideve.

Aktualisht në këtë Universitet studiojnë 8.801 studentë.

Universiteti ka në strukturën e tij katër fakultete:

- Fakulteti Ekonomik;
- Fakulteti Shkencave Teknike;
- Fakulteti i Shkencave Humane;
- Fakulteti i Shëndetit Publik.

*Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës* është një institucion publik i arsimit të lartë. Aktualisht në këtë Universitet studiojnë 17.591 studentë. Universiteti "Aleksandër Moisiu" ka si qëllim primar nxitjen dhe zhvillimin e të menduarit kritik për të rritur përgjegjësinë dhe angazhimin ndaj çështjeve individuale dhe sociale, në frymën e një përmirësimi të vazhdueshëm të standardeve akademike bashkëkohore kombëtare dhe ndërkombëtare.

UAMD ka në përbërjen e tij gjashtë fakultete:

- Fakulteti i Biznesit;
- Fakulteti i Edukimit;
- Fakulteti i Studimeve Profesionale;
- Fakulteti i Shkencave Politike-Juridike;
- Fakulteti i Teknologjisë së informacionit;
- Fakulteti i Studimeve të Integruara me Praktikën.

*Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër* është themeluar që në vitin 1957. Universiteti i Shkodrës ka si mision krijimin, zhvillimin dhe transmetimin e dijes me anë të mësimdhënies, duke mbështetur zhvillimin kulturor dhe ekonomik. Aktualisht në këtë Universitet studiojnë 7.927 studentë.

Universiteti i Shkodrës ka në përbërjen e tij, gjashtë fakultete:

- Fakulteti i Shkencave Shoqërore;
- Fakulteti i Shkencave të Natyrës;
- Fakulteti i Shkencave të Edukimit;
- Fakulteti Ekonomik;
- Fakulteti i Drejtësisë;
- Fakulteti i Gjuhëve të Huaja.

#### 1.4.1 HYRJE

Ministria përgjegjëse për arsimin është institucioni që realizon programin qeverisë në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.

**Ministria Arsimit, Sportit dhe Rinisë** ka si mision hartimin dhe zbatimin e politikave në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, që synojnë sigurimin e një sistemi arsimor cilësor si dhe miratimin e planit strategjik në këtë fushë, zhvillimin perspektiv të arsimit, respektimin e interesave të individit, komunitetit e të shoqërisë dhe pajisjen me njohuritë e nevojshme për t'u përballur me kërkesat e ekonomisë së tregut, në përputhje me përparësitë kombëtare dhe europiane, krijimin, transmetimin, zhvillimin dhe mbrojtjen e dijeve me anë të mësimdhënies e të shërbimeve.

Ministria harton, programon, zhvillon dhe bashkërendon punën për politikát kombëtare në fushën e arsimit, sportit dhe rinisë, integrimin kulturor, harton politikát mbrojtëse dhe promovuese, si dhe krijon hapësirat e nevojshme për zhvillimin dhe përmirësimin e këtyre disiplinave.

MASR harton dhe propozon bazën ligjore në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit


shkencor, ky institucion miraton hapjen e programeve të reja të studimit, riorganizimin, pezullimin e veprimtarisë akademike dhe mbylljen e tyre, kontrollon pajtueshmërinë e veprimtarisë së institucioneve të arsimit të lartë me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, auditon së paku një herë në tre vjet, përdorimin e fondeve publike në institucionet e arsimit të lartë dhe i propozon Këshillit të Ministrave kufirin maksimal të tarifës së shkollimit për programet e studimit të ciklit të parë në institucionet publike të arsimit të lartë. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë administron regjistrin shtetëror të gradave shkencore dhe titujve akademikë dhe mbështet me infrastrukturën e nevojshme veprimtaritë kërkimore-shkencore vetëm në institucionet publike të arsimit të lartë.

MASR është institucioni përgjegjës, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi, për realizimin e programit politik qeverisës në fushën e arsimit të lartë dhe të kërkimit shkencor, si dhe për sigurimin e cilësisë dhe respektimin e standardeve nga institucionet publike dhe jopublike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.

#### **Shërbimet që ofrohen pranë MASR-së janë :**

- Aktet nënligjore për implementimin e plote LAL:
- Ekuivalentimin e diplomave të marra në universitet jashtë vendit
- Regjistrimin e formave të diplomave dhe certifikatave në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor
- Hapja e programeve të reja të studimeve të Doktoraturës në Institucionet e Arsimit të Lartë.
- Mbështetje financiare të studentëve dhe shkencëtarëve të rinj të shkëlqyer (Fondi i Ekselencës).

Skema Nr.3. Organizimi i arsimit të lartë



Burimi: Grupi i KLSH

**Institucionet e Arsimit të Lartë** janë të organizuara në institucione publike, jopublike dhe publike të pavarura. Këto Institucione krijohen, hapen, organizohen, financohen, akreditohen, vlerësohen, pezullohen dhe mbylljen në përputhje me Ligjin Nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

Llojet e institucioneve të arsimit të lartë janë; universitetet, kolegjet universitare, akademitë dhe kolegjet profesionale të larta.

Misioni i këtyre Institucioneve është:

- Krijimi, trasmetimi, zhvillimi dhe mbrojtja e dijeve me anë të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve për të tretë si dhe formimi i specialistëve të lartë dhe shkencëtarëve të rinj;
- Të ofrojnë mundësinë për përfitim nga arsimit i lartë gjatë gjithë jetës;
- Të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik, social, kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal;
- Të integrojnë mësimdhënien me kërkimin shkencor;
- Të realizojnë bashkpunim në nivel ndërkombëtar me institucione homologe në fushën e arsimit të lartë;
- Të kontribuojnë në rritjen e standarteve të demokracisë e të qytetërimit të shoqërisë dhe në përgatitjen e të rinjve për një shoqëri të tillë.

#### 1.4.2 Politikat e Institucioneve<sup>10</sup>

*Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë* është Institucioni përgjegjës për zbatimin e politikave të Miratuara nga Këshilli i Ministrave në fushën e arsimit. Ky institucion ka në funksionet e tij detyrimin për të “zbërthyer” programin e qeverisë për fushën e arsimit, sportit dhe rinisë, nëpërmjet direktivës në përafrimin me legjislacionin e BE-së. MASR është përgjegjëse për marrjen e iniciativave dhe udhëheqjen e punës për përmirësimin e dokumentave kryesorë në fushën e arsimit, duke konceptuar dhe paraqitur propozimet kryesore të politikës shtetërore në këtë fushë.

Për rrjedhje, disa nga politikat kryesore në këtë sektor janë:

- Cilësia sipas standardeve të HEAL-së;
- Mundësi të barabarta, pa diskriminim dhe mbështetje për shtresat në nevojë;
- Konkurrencë e lirë mes institucioneve të arsimit të lartë, personelit akademik dhe studentëve;
- Mundësi për të gjithë mbi bazën e meritës;
- Mbështetje të përparësive strategjike të zhvillimit të vendit nëpërmjet kërkimit shkencor.
- Arsimit i lartë duhet t’u përgjigjet, t’u përshtatet dhe t’u paraprijë ndryshimeve në tregun e punës dhe në zhvillimin e vendit.

Në kuadër të misionit dhe vlerave bazë, politikat e *Institucioneve të Arsimit të Lartë* janë si vijojnë:

- Rritja e motivimit dhe performancës me një qëndrim pjesmarrës dhe bashkëpunues po aq sa transparent;
- Ofrimi i shërbimeve për stafin dhe studentët duke përdorur sistemet e informacionit dhe duke konsideruar nevojat e përdoruesit, zhvillimin teknologjik, sigurinë e informacionit, eficientë dhe efektivitetin e informacionit dhe vazhdimin e shërbimeve;
- Zhvillimin e një sistemi menaxhimi të cilësisë eficient dhe konkret duke përdorur me efektivitet burimet dhe kohën për të arritur targetin e dëshiruar;
- Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së shërbimit dhe aktiviteteve;
- Përditësimi i vazhdueshëm në përputhje me kërkesat e kohës dhe me ecurinë e shkencës, objektivat, qëllimet, kompetencat dhe rezultatet e nxënies nga programet që ofron universiteti;

<sup>10</sup> Raporti përfundimtar për reformimin e Arsimit të Lartë dhe kërkimit shkencor-Korrik 2014

- Realizimi dhe nxitja e mbështetjes së kërkimit shkencor;
- Krijimi i një mjedisi që favorizon stafin akademik të ndjek zhvillimet më të reja shkencore;
- Adaptimi i një sistemi menaxhim bashkëpunues, pjesmarrës, efektiv dhe inovativ.

### 1.4.3 Pesha në buxhet dhe GDP

Për vitin 2017, Ministria e Arsimit Sporti dhe Rinisë ka administruar dhe menaxhuar fondet buxhetore sipas gjashtë programeve të listuar në tabelën nr.1. Fondet e miratuara me Ligjin nr. 130/2016 datë 17.12.2016, "Për buxhetin e vitit 2017" për MASR ishin 34 miliardë e 721 milionë lekë. Fondi Buxhetor për arsimin për vitin 2017 përbënte rreth 7,41% të totalit të shpenzimeve publike dhe 2,18% të Produktit të Brendshëm Bruto. Fondet buxhetore të planifikuara në programin e arsimit të lartë për vitin 2017 janë 6 miliardë e 333.3 milionë lekë i cili transferohet pranë IAL-ve nëpërmjet grantit të mësimdhënies. Buxheti i shteti shpenzon për arsimin e lartë rreth 385 euro<sup>11</sup>/student<sup>12</sup> në IAL publike.

Tabela nr. 1 Fondet buxhetore sipas programeve buxhetore për vitin 2017 dhe 2018  
(Në milionë lekë)

Nr	Emri i programit	Buxheti për 2017 <sup>13</sup>	Buxheti për 2018 <sup>14</sup>
1	Planif.menaxhim administrim	715.0	797
2	Arsimi bazë	20,477.3	22,175
3	Arsimi i mesëm i përgjithshëm	6,333.3	7,095
4	Arsimi i lartë (Granti i mësimdhënies)	6,643.0	7,305
5	Kërkimi shkencor	365.8	480
6	Programi për Sportin	186.6	522
<b>Totali</b>		<b>34,721.0</b>	<b>38,374</b>

Burimi: Grupi i Auditimit dhe MASR

Gjatë vitit 2017 IAL-të, subjekt auditimi planifikuan dhe financuan aktivitetin e tyre akademik dhe financiar sipas buxhetit të pasqyruar në tabelen nr.2. Fondi i trasferuara nga MASR nëpërmjet grantit për mësimdhënie përbëhet:

a) fondi per IAL;

b) fondi për mbështetjen studentore nëpërmjet bursave shteteror.

Kriteret dhe kategoritë përfituese janë përcaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave.<sup>15</sup>

<sup>11</sup> Kursi zyrtar për vitin 2017: 1euro=140 lek

<sup>12</sup> Sipas MASR-së; Gjatë vitit akademik 2017/18, në IAL-të publike kanë studiuar 123,159 studentë

<sup>13</sup> Ligjin nr. 130/2016 datë 17.12.2016, "Për buxhetin e vitit 2017"

<sup>14</sup> Ligjin nr. 109/2017 datë 18.12.2017, "Për buxhetin e vitit 2018"

<sup>15</sup> VKM Nr. 903, datë 21.12.2016 për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë

Tabela nr.2. Financimi i IAL-ve subjekt auditimi për vitin 2017<sup>16</sup>

(Në mijë lekë)

Institucion i Arsimit të Lartë Publik	Viti 2017			
	Granti i mësimdhënies		Të ardhura dytësore	Totali
	Fondi për IAL	Fondi për Bursa		
Universiteti i Tiranës	1,080,665	78,000	1,081,152	2,239,817
Universiteti Bujqësor, Tiranë	584,030	35,000	348,837	967,867
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	478,758	38,170	436,778	953,706
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	506,930	36,230	304,839	847,999
Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër	356,852	48,800	194,831	600,483
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	317,085	20,300	122,252	459,637
Universiteti "Fan S. Noli" Korçë	261,356	24,000	95,154	380,510

Burimi: Grupi i Auditimit dhe MASR

#### 1.4.4 Risqet e aktivitetit të subjektit

Risqet e aktivitetit të institucioneve të arsimit të lartë, lidhur me cilësinë e shërbimeve studentore, janë analizuar dhe paraqitur duke i evidentuar dhe klasifikuar fillimisht sipas analizës SWOT: Fuqitë, dobësitë, shanset, kërcënimet, të klasifikuar në faktorë të brendshëm dhe të jashtëm. Risqet e aktivitetit të institucioneve të arsimit të lartë janë ato me të cilat përballen këto institucione, në lidhje me realizimin e objektivave dhe misionit e tyre bazuar në legjislacionin në fuqi.

#### ANALIZA SWOT

Duke iu referuar evidentimit të fuqive, dobësive, shanseve dhe kërcënimeve të paraqitur në analizën SWOT, grupi i auditimit ka bërë një ndarje dhe grupim të risqeve të veprimtarisë së institucioneve përkatëse, për të adresuar dhe ndarë faktorët e riskut sipas përkatësisë së tyre, brenda kontrollit dhe jashtë kontrollit menaxherial. Gjithashtu është bërë edhe kategorizimi i tyre në strategjik, financiar, juridik dhe operacional.

- Risqet brenda kontrollit menaxherial janë konsideruar të gjitha ato që më lart janë përfshirë tek Fuqitë & Dobësitë;
- Risqet jashtë kontrollit menaxherial janë konsideruar të gjitha ato që më lart janë përfshirë tek "Shanset & Kërcënimet".

Tabela nr. 3. Analiza SWOT për shërbimet studentore

Fuqitë (S)	Dobësitë (W)
Autonomia financiare për IAL publike	Planifikim i dobët i kërkesave në PBA-të respektive të fakulteteve për shërbimet studentore

<sup>16</sup> Shkresa e MASR me nr.12966/2 Prot. date 11.01.2017 "Detajimi shpenzimeve ... për vitin 2017"

Hartimi dhe miratimi i buxhetit të IAL-ve nga Bordet e Administrimit.	Numri i ulët i shërbime studentore
Ekzistenca e sistemeve informatike për manaxhimin e shërbimeve studentore.	Mungesa e Strategjisë për Arsimin e Lartë
Trasferimi i studentëve nga IAL-të brenda vendit	Struktura administrative të fryra dhe jo eficiente pranë rektorateve
Përfitimi i bursave nga studentët nga buxheti i shtetit	Koha e gjatë për marrjen e shërbimeve studentore
Trasferimi i përkohëshëm i krediteve në programet Erasmus	Mos shfrytëzimi i autonomisë financiare nga ana e IAL-ve
Financimi me bursa nga shteti për studentët e ekselences për studime jashtë vendit	Mungesa e studimit të llogaritjes së kostove të shërbimeve studentore
Egzistenca e Qendrës së karrierës	Mungesa e shërbimeve on line
Vendosja e tarifave të studimit nga BA pranë IAL-ve për ciklin e dytë të studimeve - master shkencor dhe profesional	Mungesa e një plani strategjik nga IAL-të për rritjen e cilësisë së shërbimeve ndaj studenteve.
Vendosja e tarifave të studimit nga BA për ciklin e tretë të studimeve - doktoraturë	Mungesa e rritjes së burimeve të financimit përmes aplikimeve dhe përfitimit në projekte të kërkimit shkencor
Informimi i studentëve dhe sigurimi i komunikimit ndërmjet tyre dhe personelit akademik nëpërmjet faqeve zyrtare web dhe rrjeteve sociale	Mungesa e rinovimit të fondit të bilotekave si dhe mungesa e bibliotekave elektronike
<b>Shanset (O)</b>	<b>Kërcënimet (T)</b>
Struktura ligjore e sistemit të Arsimin të lartë	Mungesa e akteve nënligjore për implementimin e plotë të LAL
Reformat e nisura në fushën e arsimit të lartë	Mungesa e dhënies së kredisë studentore
Ekzistenca e praktikave të mira të vendeve të zhvilluara	Mungesa e këshillave studentor në disa IAL
Presioni i publikut për rritjen e cilësisë së arsimit	Mungesa e hartimit të kriterëve nga MASR për kartën e studentit
Rritja e inovacioneve dhe IT-së në fushën e shërbimeve studentore	Cilësia e shërbimeve studentore në IAL-të jo-publike.
Mundësia për të krijuar një imazh të mirë për universitetin duke përdorur praktikën më të mira ndërkombëtare në fushën e arsimit të lartë	Mungesa e vendosjes së kriterëve ligjor për përcaktimin e anëtarëve përfaqësues të MASR në bordet e administrimit

Vlerësimi i nevoja të komunitetit për programe studimi specifik

Burimi: Grupi i auditimit KLSH

Tabela Nr. 4. Kategorizimi i Riskut në strategjik, financiar, juridik, operacional

Nr.	Risku i Subjektit	Kategorizimi i riskut	Niveli i Riskut
<b>Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë</b>			
1	Niveli i ulët i financimit të Arsimit të Lartë	Risk Strategjik	I Lartë
2	Mungesa e akteve nënligjore për implementimin e plotë të LAL	Risk Rregullator dhe Juridik	I Mesëm
<b>IAL-të</b>			
1	Mungesa e një plani strategjik për rritjen e cilësisë së shërbimeve ndaj studenteve	Risk Strategjik	I Lartë
2	Mungesa e kartës së studentëve	Risk Strategjik	I Mesëm

Burimi: Grupi i auditimit KLSH

#### 1.4.5 Rëndësia e produkteve të subjektit.

IAL-të janë të organizuara në institucione publike dhe jopublike. Institucionet e arsimit të lartë krijohen, hapen, organizohen, financohen, akreditohen, vlerësohen, pezullohen dhe mbyllen në përputhje me LAL dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. Llojet e institucioneve të arsimit të lartë janë: universitetet, kolegjet universitare, akademitë dhe kolegjet profesionale të larta.

IAL-të përgjithësisht ofrojnë shërbimet e mëposhtëmve:

##### 1) Karta e studentit

- I. Akses brenda fakultetit
- II. Akses jashtë ambientit të fakultetit

##### 2) Sekretaria mësimore

- I. Rregjistrim në provim
- II. Grafiku i provimeve
- III. Rezultatet e provimeve
- IV. Data e mbrojtje Diplome
- V. Transferim i studimeve
- VI. Lëshimi i Diplomës për program studimi të akredituar
- VII. Program studimi
- VIII. Vërtetim studimi
- IX. Listë notash

##### 3) Zyra e financës

- I. Bursa studimi
- II. Shmangia nga tarifat e studimit
- III. Kredi studentore



IV. Tarifat e studimit

**4) Kërkim shkencor**

a) Financimi nga MASR nëpërmjet AKKSHI

b) Financimit nga IAL-të

I. Projekte

II. Konferenca shkencore

III. Bashkepunime

IV. Botime

V. Bibloteka

VI. Biblotekave elektronike

**5) Aksesit në informimin logjistik**

I. Shërbime online

II. E-mail zyrtar

III. Faqe zyrtare Web

IV. Rrjetet sociale

**1.4.6 Feedback-u i subjektit në fazën studimore**

Gjatë fazës studimore, MASR, Universiteti i Tiranës, Universiteti i Vlorës, Universiteti i Korçës, Universiteti Bujqësor i Tiranës, Universiteti i Mjeksisë, Universiteti i Durrësit dhe Universiteti i Shkodrës i janë përgjigjur përgjithësisht në kohë takimeve prezantuese dhe konsultuese, si dhe plotësimit të informacionit të kërkuar, kryesisht me dokumentacionin që lidhet me përcaktimin e shërbimeve të ofruara për studentët, përcaktimin e kostove të këtyre shërbimeve, garantimin dhe vënien në zbatim të autonomisë që ligji për arsimin e lartë iu njeht IAL-ve etj.

MASR ka vënë në dispozicion të gjithë informacionin e kërkuar, i shoqëruar edhe me dokumentet përkatëse, sipas rastit edhe në format elektronik. Janë treguar të gatshëm në komunikime për trajtimin e çështjeve të ndryshme që grupi i auditimit vendosi që t'i trajtonte.

Specialistë të departamenteve si dhe personat e përfshirë në procesin e punës në *Universitetin e Tiranës* ka dëshmuar një nivel të lartë bashkëpunimi dhe profesionalizmi, duke ndihmuar grupin e auditimit me eksperiencën dhe idetë e tyre.

Pas takimit prezantues me Rektoren e Universitetit të Tiranës grupi vijoi takimet me Administratorin, Zv. Rektoret dhe Kryetaren e Bordit të Administrimit. U zhvillua takim edhe me Drejtuesin e Drejtorisë së Marrëdhënieve me Jashtë dhe Studentët. Më tej grupi i audituesve vizitoi fakultetet e këtij universiteti, për të parë ofrimin e shërbimeve studentore. Grupi auditues zhvilloi takime në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Fakultetin e Shkencave Sociale dhe Fakultetin e Ekonomisë. Dekanët e këtyre fakulteteve na dhanë një tablo të detajuar për fokusin e këtij auditimi, duke na sjell në vëmendjen e grupit çështje që ndikojnë në rritjen e efikasitetit të shërbimeve studentore dhe rritjen e punimeve dhe kërkimit shkencor, si një produkt shumë i rëndësishëm për arsimin e lartë. Gjithashtu grupi auditues pati takime dhe me Administratorët dhe me disa Zv. Dekan të këtyre fakulteteve, duke zhvilluar me ta takime konsultuese, kryesisht me përcaktimin e shërbimeve të ofruara për studentët dhe përcaktimin e kostove të këtyre shërbimeve dhe financimin e kërkimit shkencor në nivel departamenti. Gjatë vizitës në Fakultete, grupi i punës vizitoi ambientet pranë të cilave studentët marrin shërbime, si edhe sekretariatë mesimore. Takime u zhvilluan

gjithashtu edhe me studentët e këtyre Fakulteteve, me qëllim marrjen e feedback-ut mbi shërbimet që ata përfitojnë pranë fakulteteve respektive.

Grupi shpreh vlerësim të lartë për bashkëpunimin që pati me Dekanët, Zv. Dekanët dhe Administratorët, të cilët na vunë në dispozicion materiale të ndryshme edhe në format elektronik sipas rastit.

*Universiteti i Durrësit* ka vënë në dispozicion të gjithë informacionin e kërkuar, i shoqëruar edhe me dokumentet përkatëse, sipas rastit edhe në format elektronik. Janë treguar të gatshëm në komunikime për trajtimin e çështjeve të ndryshme që grupi i auditimit vendosi t'i trajtonte.

*Universiteti i Vlorës* ka vënë në dispozicion të gjithë informacionin e kërkuar, i shoqëruar edhe me dokumentet përkatëse, sipas rastit edhe në format elektronik. Janë treguar të gatshëm në komunikime për trajtimin e çështjeve të ndryshme që grupi i auditimit vendosi t'i trajtonte.

*Universiteti i Korçës* ka vënë në dispozicion të gjithë informacionin e kërkuar, i shoqëruar edhe me dokumentet përkatëse, sipas rastit edhe në format elektronik. Janë treguar të gatshëm në komunikime për trajtimin e çështjeve të ndryshme që grupi i auditimit vendosi t'i trajtonte.

*Universiteti i Shkodrës* ka vënë në dispozicion të gjithë informacionin e kërkuar, i shoqëruar edhe me dokumentet përkatëse, sipas rastit edhe në format elektronik. Janë treguar të gatshëm në komunikime për trajtimin e çështjeve të ndryshme që grupi i auditimit vendosi t'i trajtonte.

*Universiteti Bujqësor i Tiranës* ka vënë në dispozicion të gjithë informacionin e kërkuar, i shoqëruar edhe me dokumentet përkatëse, sipas rastit edhe në format elektronik. Janë treguar të gatshëm në komunikime për trajtimin e çështjeve të ndryshme që grupi i auditimit vendosi t'i trajtonte.

*Universiteti i Mjekësisë*, pas takimit prezantues me rektorin e UMT, grupi i auditimit mendoi që të mos e përfshinte në fazën studimore këtë universitet, për shkak të numrit të lartë të subjekteve nën auditim për ta përfshirë atë gjatë fazës së terrenit. Për këtë arsye vlerësimin në drejtim të bashkëpunimit do ta shprehim gjatë hartimit të projekt-raportit të auditimit.

**Objekti i këtij auditimi ka ngjallur interesimin e institucioneve nën auditim, për problematikat që do të evidentohen në lidhje me vlerësimin e veprimtarisë së këtyre institucioneve përgjegjëse për ofrimin cilësorë të shërbimeve studentore.**

## **2. QASJA DHE DETAJET E AUDITIMIT**

Grupi i auditimit u njoh fillimisht gjatë fazës studimore me kuadrin ligjor e rregullator të subjekteve nën auditim, ku përcaktohen detyrimet dhe përgjegjësitë në lidhje me përcaktimin dhe llojet e shërbimeve studentore pranë IAL-ve publike. Njëkohësisht dhe përdorimi i burimeve me efikasitet dhe efektivitet. Më pas u zhvilluan takime prezantuese dhe intervista njohëse me pyetje të hapura me të gjithë aktorët e përfshirë në proces, për të kuptuar hartën konjitive të procesit dhe testuar informacionin e marrë nga burime të ndryshme. Bazuar në dokumentacionin e grumbulluar dhe të analizuar, të dhënat e kërkuara dhe të plotësuara nga subjektet nën auditim, komunikimet me stafin, pasqyrimin në media të këtij aktiviteti publik, si dhe hulumtimet nga praktikantët e vendeve të tjera në këtë fushë gjatë fazës studimore, qasja audituese që do të aplikohet

në vijim do të jetë pragmatiste. Kjo do të thotë se grupi i auditimit do të ndjekë qasjen normative, duke iu referuar respektimit nga ana e institucioneve të përfshira të Ligjit, akteve nënligjore, rregulloreve e praktikave të mira, sikurse edhe qasjen problemore, për të parë më nga afër cilësinë e shërbimeve të ofruara nga IAL-të.

Grupi i auditimit gjatë fazës studimore u njoh me llojet e shërbimeve që ofrohen në IAL-të subjekt auditimi, duke vizituar fakultete dhe sekretari mësimore ku ofrohen shërbimet studentore si dhe takime me student të ndryshëm pranë këtyre fakulteteve. Gjithashtu grupi i auditimit pati takime dhe me student përfaqësues në Senatin e Universitetit të Tiranës dhe të Vlorës duke marrë informacione të vlefshme mbi objektin e këtij auditimi.

## **2.1. OBJEKTIVI DHE PROBLEMI I PERFORMANCËS**

Shqetësimi kryesor i studenteve të IAL-ve publike është cilësia e shërbimeve studentore dhe tarifat e studimit. Ndërkohë që mungesa e nxjerrjes së akteve nënligjore nga ministria përgjegjëse për arsimin si dhe nevoja për të zhvilluar një kulturë të orientuar drejt cilësisë së shërbimeve në IAL-të publike nënvizoi domosdoshmërinë e vlerësimit të burimeve dhe mekanizmave të përdorur, për realizimin e objektivave të institucioneve të arsimit të lartë për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve studentore.

### **2.1.1 Fokusimi dhe përkufizimi i problemit të performancës**

Mungesa e nxjerrjes së akteve nënligjore nga MASR për implementimin e plotë të LAL ka ndikuar në efikasitetin e shërbimeve studentore, si rrjedhojë në cilësinë e tyre të ofruara nga IAL-ve publike. Fokusimi i këtij auditimi do të jetë vlerësimi i efikasitetit të shërbimeve studentore për IAL-të publike subjekt i këtij auditimi përgjatë vitit akademik 2017-2018.

### **2.1.2 Objektivi i auditimit**

Rritja e cilësisë së shërbimeve të ofruara nga IAL-të publike dhe vlerësimi i tarifave mbi bazën e një analize kostoje do të ndikonin në rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të këtyre shërbimeve ndaj studentit.

Në këtë mënyrë, objektivi i këtij auditimi do të jetë:

**Vlerësimi i cilësisë së shërbimeve studentore dhe kostimi i shërbimeve ndaj studentëve për të përcaktuar tarifën e studimit dhe tarifat e shërbimeve të tjera studentore do të ndikonte në rritjen e efikasitetit të shërbimeve studentore.**

## **2.2. PËRKUFIZIMET DHE TERMINOLOGJIA**

- **Arsimi i lartë:** Është arsimimi që ofrohet pas arsimit të mesëm nga institucionet e arsimit të lartë, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe akteve të tjera nënligjore.
- **Autonomia Universitare:** Nënkupton pavarësinë e IAL-ve në marrjen e vendimeve për drejtimin, organizimin dhe funksionimin e tyre, e shprehur në 4 forma kryesore: autonomi financiare, autonomi akademike, autonomi organizative, autonomi e personelit.
- **Bordi Administrativ:** Organi përgjegjës për performancën financiare të çdo IAL-je.
- **Bursa:** Është financimi monetar që jepet për të mbështetur arsimimin e një studenti, mbi bazën e arritjeve akademike të tij ose kritereve të tjera, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

- **Departament:** Është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore të fakultetit.
- **Dokumenti i prioriteteve:** Është dokumenti që përcakton strukturën e shpenzimit të fondit publik për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, në përputhje me prioritetet e vendit.
- **ECTS – European Credit Transfer System:** Është përcaktimi i kreditit, sipas Sistemit Europian të Transferimit të Krediteve të formimit në arsimin e lartë.
- **Fakultet:** Është njësi kryesore që bashkërendon mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në fusha të përafërta ose të ndërthurura.
- **Gjurmimi i studentëve:** Është procesi i ndjekjes së studentit, lidhur me kualifikimet e tij të mëtejshme dhe punësimit, sipas programit të ndjekur.
- **Institucionet e Arsimit të Lartë:** Janë personat juridikë që ofrojnë arsimim të lartë ose kualifikim profesional pas arsimit të mesëm dhe, sipas llojit të institucionit, edhe kërkim shkencor, si pjesë e sistemit të arsimit të lartë, të krijuar, dhe që ushtrojnë veprimtarinë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- **Kërkimi shkencor bazë:** Është veprimtaria kërkimore-shkencore, që ka për qëllim kryesor zgjerimin, thellimin, rikonceptimin dhe riintegrimin e njohurive shkencore mbi fenomenet e studiuara dhe të kuptuarit teorik të ndërveprimit midis aktorëve të ndryshëm dhe vetë procesit ku ato ndikojnë.
- **Kërkimi shkencor i zbatuar:** Është veprimtaria kërkimore-shkencore, që ka për qëllim të gjejë zgjidhje praktike dhe specifike me objektiv kryesor shfrytëzimin e njohurive teorike, me qëllim zbatimin e tyre në praktikë.
- **Kodi i cilësisë:** Është përmbledhje e standardeve dhe udhëzimeve për sigurimin e brendshëm e të jashtëm të cilësisë në arsimin e lartë.
- **Risku:** Mundësia e ndodhjes së një ngjarjeje të caktuar, e cila do të ndikonte negativisht në arritjen e objektivave të një njësie organizative apo të shoqërisë në tërësi.
- **Senati:** Është organi kolegjal akademik vendim-marrës më i lartë, i cili zgjidhet nga Personeli Akademik me kohë të plotë i njëjësive kryesore me votim të përgjithshëm.
- **Sigurimi i brendshëm i cilësisë:** Është procesi i vazhdueshëm i monitorimit, vlerësimit, garantimit, ruajtjes dhe përmirësimit të cilësisë së veprimtarisë në institucionet e arsimit të lartë, që zhvillohet nga vetë institucionet.
- **Sistemi i studimeve me kohë të plotë:** Përfshin organizimin e programeve të studimit me ngarkesë akademike normale 60 kredite ECTS në një vit akademik.
- **Sistemi i studimeve me kohë të zgjatur:** Përfshin organizimin e programeve të studimit me të njëjtën ngarkesë akademike totale të programeve të studimit me kohë të plotë, por me kohëzgjatje më të madhe e që në asnjë rast nuk mund të kalojë dyfishin e kohëzgjatjes normale.
- **Strategjia:** Orientimi i politikave afatmesme dhe afatgjata sektoriale për përsosjen dhe modernizimin e sistemit arsimor, në përputhje me vizionin e Qeverisë.
- **Plani buxhetor afatmesëm:** Është parashikimi i specifikuar i aktivitetit financiar të një institucioni të arsimit të lartë, që pritet të kryhet në një periudhë trevjeçare.
- **Plani buxhetor njëvjeçar:** Është parashikimi i specifikuar i aktivitetit financiar të një institucioni të arsimit të lartë, që pritet të kryhet në një periudhë njëvjeçare.

- **Plani strategjik i zhvillimit të institucionit:** Është dokumenti ku përcaktohen objektivat einstitucionit të arsimit të lartë apo të njësive përbërëse të tij, si dhe mjetet e mënyrat e realizimit të tyre.
- **Programi i studimit:** Është një tërësi veprimtarish akademike dhe/ose kërkimore shkencore, përfundimi me sukses i të cilave i jep të drejtën studentit të pajiset me një certifikatë, diplomë ose gradë shkencore prej institucionit të arsimit të lartë që e ofron atë, në varësi të llojit të programit të studimit.
- **Tarifa e aplikimit:** Është vlera monetare që paguan studenti për aplikim në një program studimi.
- **Tarifa e konkurrimit:** Është vlera monetare që paguan studenti për të konkurruar pranë institucionit të arsimit të lartë për të fituar në një program studimi, në ato raste kur institucioni parashikon zhvillimin e konkursit.
- **Tarifa e regjistrimit:** Është vlera monetare që paguan studenti për t'u regjistruar në një program studimi.
- **Tarifa e shkollimit:** Është vlera monetare që paguan studenti për ndjekjen e një programi studimi pranë një institucioni të arsimit të lartë.
- **Tarifa e studimit:** Përfshin tarifën e regjistrimit dhe tarifën e shkollimit.

### 2.3. BURIMET E KRITEREVE

#### 2.3.1 Kriteret e politikës

- Strategjia Kombëtare e Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit 2017-2022;
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020.
- Strategjia Kombëtare për Arsimin e Lartë 2008-2013.

#### 2.3.2 Kriteret e monitorimit dhe raportimit

- Raporti përfundimtar për reformimin e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor (Korrik 2014)
- Raport i monitorimi-MASR (janar – dhjetor 2017)

#### 2.3.3 Kriteret teknike

- Ligji nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë";
- Ligji nr.9704, datë 02.04.2007 "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë për realizimin e një qendre shërbimesh dhe të një rrjeti telematik për universitetet";
- VKM nr. 903, datë 21.12.2016 "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë", i ndryshuar;
- VKM nr. 66, datë 03.02.2017 "Për përcaktimin e kriterëve e të procedurave për ngritjen e organizimin e shërbimeve dhe strukturave shëndetësore universitare";
- VKM nr.109, datë 15.02.2017 "Për organizimin dhe funksionimin e agjencisë së sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë e të bordit të akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë";

- VKM nr.329, datë 12.04.2017 “Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik”;
- VKM nr.370, datë 26.04.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e kolegjit profesional të lartë”;
- VKM nr.397, datë 03.05.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e agjencisë kombëtare të financimit të arsimit të lartë (AKFAL);
- VKM nr.418, datë 10.05.2017 “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre”;
- VKM nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruar nga institucionet e arsimit të lartë”;
- VKM nr. 88, datë 14.02.2018 “Për krijimin e Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH)”;
- VKM nr.75, datë 12.02.2018 “Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”;
- VKM nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”;
- VKM nr. 483, datë 16.07.2014 “Për Mbështetjen Financiare të Studentëve të Shkëlqyer dhe të Nënpunësve Civilë të Administratës Shtetërore” (Fondi i Ekselencës);
- Udhëzim nr.17, datë 03/08/2016 “Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në republikën e shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve 6 akademikë, të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara, jashtë vendit”;
- Udhëzim nr.8, datë 13.03.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore”;
- Udhëzim nr. 25, datë 10.11.2017 “Për regjistrimin e formave të diploma dhe certifikatave në regjistrin shtetëror të të diploma dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”;
- Udhëzim nr.27, datë 19.12.2017 “Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë”;
- Udhëzim nr.31, datë 29.12.2017 “Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga institucionet e arsimit të lartë”;
- Udhëzim nr.32, datë 29.12.2017 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr.17, datë 03.08.2016 ‘Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë ,të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucionet e huaja të autorizuara, jashtë vendit;
- Udhëzim nr.33, datë 29.12.2017 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr.16, datë 01.08.2016 “Përcaktimin e kriterëve, masës dhe procedurave për përfituesit nga fondi i ekselencës për studentët e shkëlqyer dhe nëpunësit e administratës shtetërore”;

- Udhëzim nr. 5, datë 19.02.2018 “Për përcaktimin e elementëve përbërës të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë”;
- Udhëzim nr. 7, datë 19.02.2018 “Për miratimin e elementëve dhe formës së kontratës së shërbimit ndërmjet institucionit të arsimit të lartë jopublik dhe studentit;
- Udhëzim nr.1, datë 02.02.2018 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr.25 datë 10.11.2017 për regjistrimin e formave të diplomave dhe certifikatave në regjistrin shtetëror të diplomave dhe të certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”;
- Udhëzim nr.15 , datë 16.04.2018 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 17, datë 03.08.2016 “Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar, jashtë vendit”, i ndryshuar ;
- Udhëzim nr. 16, datë 01.08.2014 “Për Përcaktimin e Kritereve, Masës dhe Proedurave për Përfituesit nga Fondi i Ekselencës për Studentët e Shkëlqyer dhe Nënpunësit e Administratës Shtetërore”;
- Udhëzim nr. 4, datë 16/03/2010 “Për marrjen e masave të sigurisë së të dhënave personale në veprimtarinë e fushës së arsimit”;
- Udhëzim nr. 29, datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë”;
- Udhëzim Plotësues nr. 01, datë 15.01.2016, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016”;
- Udhëzim Plotësues nr. 08, datë 13.01.2017, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2017”;
- Udhëzim Plotësues nr. 02, datë 19.01.2018, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018”;
- Udhëzimi nr. 13, datë 22.07.2016 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2016-2017”;
- Rregullore e Brendshme MASR nr.2457 prot., datë 09.03.2017;
- Rregullore nr.2459/1 prot., datë 15.03.2016 “Për organizimin e zgjedhjeve të para për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.
- Rregullore e Brendshme e MASR nr. 2457, datë 09.03.2017;
- Vendim Bordi i Administrimit nr. 14, datë 16.06.2017 “Për miratimin e tarifave” të Universitetit Bujqësor të Tiranës;
- Vendim Bordi i Administrimit nr. 18, datë 12.10.2017 “Për miratimin e tarifave të shkollimit për vitin akademik 16-17” Universitetit Bujqësor i Tiranës;
- Vendim Bordi i Administrimit nr. 32, datë 03.03.17 “Për miratimin e strukturës së përgjithshme” Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër;
- Vendim Bordi i Administrimit nr. 64, datë 13.10.2017 “Për miratimin e tarifës së shkollimit në programet e ciklit të parë të studimeve (Bachelor), ciklit të dytë

- (Master Shkencor dhe Profesional), viti akademik 2017-2018” Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër;
- Rregullore e Studimeve, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” Prill 2013;
  - Urdhër Ministri nr. 56, datë 08.02.2018 Për miratimin e Statutit të Universitetit “ Fan S. Noli” Korçë;
  - Raporti i Monitorimit të Universitetit të Mjeksisë të Tiranës 2014;
  - Rregullore e Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë 2014;
  - Statuti i Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë, bazuar në shkresën përcjellëse të Ministrisë të Arsimit Sportit dhe Rinisë nr. 3598 prot., datë 08.04.2016 për amendimet e reflektuara;
  - Vendim Bordi i Administrimit nr. 4, datë 02.03.2018 Për miratimin e numrit të personelit në të gjitha nivelet në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë;
  - Urdhër i Brendshëm nr. 8, datë 20.06.2018 “Për ngritjen e grupit teknik për implementimin e platformës së sekretarisë mësimore në Universitetin e Tiranës”;
  - Vendim Bordi i Administrimit nr. 225 prot., datë 04.04.2018 “Për miratimin e Buxhetit të vitit 2018”;
  - Vendim Bordi i Administrimit nr. 94, datë 04.05.2017 “Për miratimin e Buxhetit të vitit 2017”;
  - Vendim Bordi i Administrimit nr. 30, datë 31.05.2018 Për miratimin e strukturës së përgjithshme të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës;
  - Vendim i Këshillit të Administrimit nr. 11, datë 25.07.2012 Për miratimin e tarifave të pagueshme për shërbimet e ofruara ndaj të tretëve nga Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës;
  - Urdhër nr. 385, datë 09.07.2018 Për miratimin e Statutit të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës;
  - Urdhër nr. 135, datë 30.11.2017 Për ngritjen e komisionit të kryerjes së inventarizimit, për Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës.

#### **2.3.4 Kriteria të tjera/Praktikat më të mira**

##### **SISTEMI I ARSIMIT TË LARTË NË GJERMANI.**

Sistemi arsimor ndryshon nga njëri vend në tjetrin në të gjithë Gjermaninë sepse çdo shtet (Land) vendos politikën e veta arsimore. Përgjegjësia për sistemin arsimor në Gjermani është kompetencë e shteteve (Landeve), ndërsa qeveria federale luan një rol më të vogël në organizimin e këtij sistemi. Universitetet e Gjermanisë njihen ndërkombëtarisht; në rankimin akademik të Universiteteve Botërore (ARËU). Për vitin 2008, 6( gjashtë) nga 100 universitetet më të mira në botë janë Gjermane. Gjermania renditet e treta në renditjen botërore të Universiteteve QS 2011. Shumica e universiteteve gjermane janë institucione publike. Kështu, arsimi akademik është i hapur dhe ofrohet për të gjithë qytetarët, të cilët plotësojnë kërkesat paraprake për kualifikim dhe kanë interesim të aftësohen në një fushë të caktuar.

*Universitetet Gjermane kanë një fokus të fortë në kërkimin shkencor, një pjesë e madhe e këtyre kërkimeve bëhen edhe jashtë universiteteve në institute të pavarura që janë të përfshira në grupe akademike, si: Max Planck, Fraunhofer, Leibniz dhe Helmholtz. Kjo veçori gjermane e hulumtimit "outsourcing" çon në një konkurs për fonde midis*



universiteteve dhe instituteve kërkimore dhe mund të ndikojë edhe në renditjen akademike.

### **Llojet e Universiteteve**

Sistemi gjerman i arsimit të lartë dallon midis dy llojeve të Institucioneve të Larta Arsimore: Termi *Universität* (universitet) përdoret për institucionet të cilat kryejnë edhe veprimtari kërkimore e shkencore dhe kanë të drejtën e dhënies së gradës së Doktoraturës dhe titullit Profesor. Institucionet e tjera të arsimit të lartë për dhënien e diplomeve të tjera, të cikleve më të ulta të studimit të lartë njihen me termin e përgjithshëm *Hochschule*.

Struktura organizative e universiteteve gjermane i kthehet modelit të universitetit të paraqitur nga *Ëilhelm von Humboldt* në fillim të shekullit të 19-të, i cili identifikon si ideale unitetin e mësimdhënies dhe kërkimit si dhe lirinë akademike. Ky model çoi në themelimin e Universitetit Humboldt në Berlin dhe ka ndikuar gjithashtu në sistemin e arsimit të lartë të shumë vendeve gjermane.

Në universitetet gjermane, studentët regjistrohen për një program studimi (*Studiengang*). Gjatë studimeve të tyre, ata zakonisht mund të zgjedhin lirisht nga të gjitha kurset e ofruara në universitet. Megjithatë, të gjitha programet e nivelit bachelor kërkojnë një numër kursesh të detyrueshme dhe të gjitha programet e diplomave kërkojnë një numër minimal të kredive që duhet të fitohen në fushën kryesore të programit të studimit. Ndodh që ciklet e studimit të zgjatën përtej periudhës së rregullt të studimit (*Regelstudienzeit*) në universitet dhe nuk ka klasa fikse të studentëve që studiojnë dhe diplomohen sëbashku. Studentët mund të ndryshojnë universitetin sipas interesave të tyre dhe pikave të forta të çdo universiteti. Ata kanë të drejtë të ndjekin shumë universitete të ndryshme gjatë studimeve të tyre. Kjo "larmishmëri" nënkupton faktin që në universitetet gjermane ekziston një liri dhe individualitet i panjohur në SHBA, Britaninë e Madhe ose në Francë. Profesorët gjithashtu zgjedhin lirisht vetë lëndët e tyre për kërkime shkencore dhe mësimdhënie, kjo liri akademike përcaktohet në kushtetutën gjermane.

Meqenëse universitetet gjermane nuk ofrojnë strehim ose ushqim, *Studentenwerk* një organizatë jofitimprurëse për studentët ofron akomodim me çmim të lirë në konvikte. Këto vende janë të limituara dhe mund të përmbushin nevojat vetëm për një pjesë të studentëve. *Studentenwerk* gjithashtu drejton kantina dhe kafene në kampus, të cilat janë të përbalueshme dhe ofrojnë çmime preferenciale për studentët.

### **Financimi dhe Mbështetja e Studentëve**

Shteti gjerman mbështet fuqishëm arsimin e lartë dhe financon universitetet, duke mbuluar pagesat e shkollimit. Përveç kësaj, qeveria gjermane gjithashtu përfshin programe të mbështetjes financiare për studentët.

- Shërbimi për Shkëmbimin Akademik Gjerman (DAAD) është një program ndihme financiare që fokusohet tek studentët dhe studiuesit gjermanë dhe ndërkombëtarë.
- Deutschlandstipendium - ofron çmime prej 300 euro/muaj për studentët e talentuar për të paktën dy semestra.

### **Tarifat e shkollimit**

Universitetet publike në Gjermani financohen nga shtetet federale dhe nuk caktojnë tarifa për shkollim. Universitetet publike në Gjermani nuk kanë tarifa shkollimi për programet Bachelor dhe Master (me përjashtim të rasteve kur programi Master fokusohet në një degë tjetër, të ndryshme nga ajo në Bachelor). Sistemi i arsimit falas

është në dispozicion për të gjithë studentët ndërkombëtarë, pavarësisht vendit të tyre të origjinës.

Gjermanët në përgjithësi besojnë se arsimiti nuk duhet të trajtohet si produkt komercial dhe se qasja e lirë në arsimin e lartë siguron rritje ekonomike dhe mirëqenie për një popullatë më të madhe. Në vitin 2005, Gjykata Kushtetuese Federale gjermane vendosi ta shpallte jokushtetues ligjin federal që ndalonte pagesat për shkollim, me arsyetimin se arsimiti është në diskrecionin e vetë shteteve. Pas këtij vendimi, shtatë shtete federale filluan pagesat e shkollimit prej 500 euro për semestër në vitin 2006 dhe 2007. Për shkak të protestave masive të studentëve dhe një iniciative qytetare ku u mbledhën 70,000 nënshkrime kundër taksës së shkollimit, tarifat e shkollimit u hoqën sërish në vitin 2014.

Gjithashtu, qeveritë e Gjermanisë të viteve të fundit kanë realizuar përfitime ekonomike dhe sociale nga emigracioni. Gjermania dëshiron të tërheqë për të studiuar dhe për tu përshtatur më pas me tregun e punës dhe jetesën në mënyrë ideale të gjithë "mendjet e ndritura" brenda dhe jashtë Europës, dhe si pasojë kjo është arsyeja pse ata në përgjithësi i kundërshtojnë tarifat e shkollimit për të huajt.

Me shumë polemika, shteti i Baden-Ëürttemberg ka rivendosur tarifat e shkollimit në universitetet publike duke filluar nga 2017. Nga vjeshta 2017, studentët të cilët nuk janë shtetas të një shteti anëtar të BE / EEA pritet të paguajnë 1.500 euro për semestër. Kjo përfshin universitetet në Shtuttgart, Karlsruhe, Mannheim, Freiburg, Heidelberg, dhe disa qytete të tjera.

Megjithatë, të gjithë studentët e regjistruar në një universitet publik në Gjermani duhet të paguajnë një tarifë semestrale administrative për universitetin. Tarifa e semestrit zakonisht varion midis 100-300 euro për semester dhe mbulon shërbimet e organizatës së studentëve dhe regjistrimin. Kjo tarifë gjithashtu mbulon një biletë transporti publik për qytetin dhe ndonjëherë edhe për zonat përreth.

Në Gjermani janë rreth 300 universitete publike, dhe ka më shumë se 1,000 programe studimi në total. Disa nga universitetet më të mëdha publike janë:

- Universiteti i Këlnit
- Universiteti Ludëig Maximilians në Mynih (LMU)
- Universiteti Goethe Frankfurt
- Universiteti i RËTH Aachen
- Universiteti i Munster-it
- Universiteti Ruhr Bochum
- Universiteti i Duisburg-Essen
- Universiteti i Hamburg-ut
- Universiteti i FAU Erlangen-Nürnberg
- Universiteti Teknik i Mynihut (TUM)

Universitetet gjermane bëjnë dallimin midis programeve "vijuese" dhe "jo-vijuese" të Masterit. Programet vijuese janë ato që mund të regjistroheni menjëherë pas përfundimit të studimeve Bachelor. Programet jo vijuese, zakonisht kërkojnë që studentët të kenë shumë vite përvojë pune. Programet e tilla të studimit jo vijues zakonisht kanë tarifë shkollimi, madje edhe në universitetet publike.

### **Bursa për Studentët**

Në Gjermani ekzistojnë bursa të sponsorizuara nga universiteti dhe bursa të ofruara nga një numër i institucioneve publike dhe private. Zakonisht këto bursa ofrohen për të

mbuluar shpenzimet e jetesës dhe librat. Ekziston një program kredish studimi i financuar nga shteti, i quajtur BAFöG (Bundesausbildungsförderungsgesetz, "Akti federal për ndihmë arsimore"). Ai siguron që studentët më pak të pasur të marrin deri në 735 euro në muaj për periudhën standarde të studimit, nëse ata ose prindërit e tyre nuk mund t'i përballojnë të gjitha shpenzimet e përfshira në studime. Për më tepër, studentët duhet të kenë një perspektivë për tu integruar në tregun e punës në Gjermani dhe për t'u kualifikuar. Kjo e drejtë mund të përfitohet nga qytetarët e Gjermanisë dhe të BE-së, por shpesh edhe nga banorë afatgjatë të vendeve të tjera. Gjysma e këtyre parave janë një hua pa interes që më vonë paguhet, dhe që shkon mesatarisht në € 10,000. Aktualisht, rreth një e katërta e të gjithë studentëve në Gjermani marrin mbështetje financiare nëpërmjet BAFöG.

Për studentët ndërkombëtarë ka qasje të ndryshme për të marrë një bursë të plotë ose financim të studimeve të tyre. Për të qenë në gjendje për të përfituar një bursë, ata fillimisht duhet të kryejnë një aplikim të suksesshëm në fazën fillestare të pranimit në universitet.

### **Procedura e Pranimit**

Proçesi i aplikimit varet nga programi i aplikimit për arsimim, prejardhja e aplikuesit dhe kualifikimet e pranimit në universitet. Në përgjithësi, të gjitha programet e studimit ndjekin një nga tre procedurat e pranimit.

- **Hyrjet falas:** Çdo aplikant i cili plotëson kualifikimin e hyrjes në universitet do të pranohet. Kjo zakonisht praktikohet në lëndët në të cilat shumë studentë i braktisin studimet e tyre, p.sh., matematika, fizika ose inxhinieri. Ndonjëherë, numri i studentëve që nuk arrijnë të diplomohen në një program të tillë mund të jetë deri në 94 %.
- **Kufizimet e pranimit lokal:** Për programet e diplomave me një numër të kufizuar kuotash, kriteret me të cilat do të vlerësohen aplikimet e studentëve ndryshojnë nga universiteti në universitet dhe nga programi në program. Kriteret e përdorura zakonisht përfshijnë notën e provimeve përfundimtare të kualifikimit në universitet, mesataren e ponderuar, intervistat, letrat motivuese, letrat e rekomandimit nga profesorë të mëparshëm, esetë, përvojën praktike, dhe provimet e pranimit.
- **Kufizimet e pranimit kombëtar:** Në degët e mjekësisë, stomatologjisë, mjekësisë veterinare dhe farmacisë, ekziston një përcaktim kombëtar ligjor. Në këto degë, aplikimet e gjermanëve dhe të huajve që trajtohen ligjërisht si gjermanët (p.sh., qytetarëve të BE-së) trajtohen në mënyrë qendrore për të gjitha universitetet me një besim publik (Stiftung für Hochschulzulassung). Për këtë proçedurë Kuotat zbatohen kuotat e mëposhtme:
  - 20 % e kuotave të lira të pranimit jepen nga nota përfundimtare e provimit të hyrjes në universitet;
  - 20 % e kuotave u jepet studentëve që kanë numrin më të lartë të të ashtuquajturve pritëse semestrale, në të cilat nuk janë regjistruar në universitet;
  - 60 % e kuotave jepen sipas kriterëve të përcaktuara në diskrecionin e vetë universiteteve. Kriteret e universiteteve që aplikohen zakonisht në këto raste janë: 1) nota përfundimtare e kualifikimit të hyrjes në universitet, 2) intervista, 3) ese ose letra motivuese, dhe 4) provimet hyrëse.
- Disa kuota shtesë janë të rezervuara për raste të veçanta dhe nuk llogariten në tre rastet e mëparshme: Për shembull, deri në 2 % e kuotave mund të konsiderohen si


kuota të dhëna në raste vështirësie. Një aplikant mund të konsiderohet si një rast vështirësie vetëm nëse ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që e bëjnë të pamundur që aplikanti të presë për një vend në universitet, p.sh. për shkak të një sëmundjeje që ecën avancon. Sipas ligjit gjerman, universiteteve nuk u lejohej të diskriminojnë ose të japin trajtim preferencial për personat në bazë të racës, grupit etnik, gjinisë, klasës sociale, fesë apo opinionit politik.

## 2.4. PIRAMIDA E PYETJEVE AUDITUESE

### Pyetja kryesore:

*A kanë ofruar IAL-të publike shërbimet e duhura në vitin akademik 2017-2018, duke orientuar dhe optimizuar burimet e tyre drejt studentit?*

Skema nr.4: Piramida e pyetjeve audituese



Burimi: Grupi i auditimit KLSH

### Nënpyetjet e nivelit të parë:

- 1.1. A financohen IAL-të publike sipas parashikimeve të LAL<sup>17</sup> dhe akteve nënligjore?
- 1.2. A janë të mjaftueshme dhe cilësore shërbimet e ofruara nga IAL-të publike për studentët?

### Nënpyetjet e nivelit të dytë:

- 1.1.1. A financohen njësitë bazë të IAL-ve publike për kërkimin shkencor nga fondi i të

<sup>17</sup> Ligji 80/2015 për Arsimin e Lartë

- ardhurave të veta?
- 1.1.2. Sa është kontributi i përfshirjes në kërkimin shkencor i stafëve akademike dhe studentëve në IAL-të publike?
- 1.2.1. A kanë shërbyer sistemet informatike në IAL-të publike në rritjen dhe përmirësimin e shërbimeve Online ndaj studentit?
- 1.2.2. A funksionon sistemi feedback-ut në IAL-të publike për përmirësimin e shërbimeve studentore?

## 2.5. SKEMA E AUDITIMIT

### 2.5.1 Qasja/ Metodologjia audituese

Paradigma kryesore e këtij auditimi është:

*"Financimi i arsimit të lartë në Shqipëri dhe produktet e këtij financimi vijnë të mbeten çështje të parregulluara, kaotike, pa një model të qartë zhvillimi dhe larg realitetit europian ku aspirojmë të shkojmë."*

Me qëllim që futja kartës së studentit dhe shërbimet e teknologjisë së informacionit të mundësojnë rritjen e transparencës duke lehtësuar procedurat administrative dhe zvogëlimin e kostove të këtyre shërbimeve. Duke besuar që penetrimi i IT-së në sektorin e shërbimeve ndaj studentëve do të garantojë shërbim më cilësor dhe me kosto më të ulta. Duke analizuar strukturat, funksionimin dhe pozicionimin e subjekteve nën auditim, në lidhje me performancën e institucioneve të arsimit të lartë që ofrojnë shërbimet studentore, duke u përqendruar në mënyrën e organizimit të brendshëm të këtyre institucioneve, menaxhimin e burimeve të tyre, ndarjen e përgjegjësisë, në funksion të krijimit të një mjedisi të përshtatshëm për realizimin e objektivit kryesor, rritjen e cilësisë së shërbimeve ndaj studentëve dhe zvogëlimin e kostove të këtyre shërbimeve, duke e parë në funksion të rritjes së cilësisë së universitetit në përgjithësi. Përdorimi i analizës SWOT për evidentimin e faktorëve të brendshëm apo të jashtëm të cilët mund ndihmojnë ose në të kundërt të pengojnë arritjen e objektivave, i krijoj mundësinë grupit të audituesve të evidentojë dhe adresojë risqet potenciale që ndikojnë në arritjen e rezultateve dhe përmbushjen e objektivave.

### 2.5.2 Metodat & teknikat audituese

- Rishikim dhe vlerësimi i dokumentacionit të grumbulluar gjatë fazës studimore dhe asaj të terrenit.
- Komunikim me drejtuesit dhe specialistët e subjekteve nën auditim, përmes intervistave gjysëm të strukturuar.
- Pyetësor me pyetje të mbyllura dhe të hapura për studentët.
- Kryqëzim analitik i të dhënave.
- Benchmarking.
- Analizë sasiore dhe cilësore e të dhënave të mbledhura gjatë auditimit.

## 2.6. REZULTATET E PARASHIKUARA

Impakti i mesazhit auditues për Kuvendin do të ketë synim, rritjen e ndikimit të tij në përmirësimin e vazhdueshëm të akteve ligjore dhe nënligjore, të cilat mundësojnë realizimin e misionit të tyre nga institucionet e arsimit të lartë, duke mundësuar krijimin e një baze të re për rritjen e efikasitetit të këtyre shërbimeve. Mesazhi auditues do të ndikojë për qeverinë mbi domosdoshmërinë e hartimit të akteve nënligjore,

adekuate për të ndikuar në nisma qeveritare dhe parlamentare mbi rritjen e efikasitetit të këtij sektori kaq jetik për popullatën.

### **2.6.1 Impakti i mesazhit auditues për Kuvendin dhe Qeverinë**

Auditimi i performancës “Cilësia dhe tarifimi i shërbimeve studentore pranë IAL-ve publike” synon të bëjë transparente përballë publikut të gjerë një çështje shumë të rëndësishme për arsimin e lartë, rritjen e cilësisë së shërbimeve ndaj studenteve dhe vendosjen e tarifave mbi bazën e analizës së kostove të tyre. Gjithashtu, publiku i gjerë do të njihet edhe me politikat e qeverisë mbi përmirësimet ligjore në funksion të rritjes së efektivitetit të shërbimeve studentore nga IAL-te publike nëpërmjet përdorimit të kartës së studenteve.

### **2.6.2 Impakti i mesazhit auditues për publikun dhe palët e interesit**

Auditimi i performancës mbi cilësinë dhe tarifimin e shërbimeve studentore pranë IAL-ve publike, synon të ndikojë në rritjen e përgjegjshmërisë së institucioneve të sistemit të arsimit të lartë, nëpërmjet transparencës përballë opinionit publik, duke evidentuar problematikat dhe mangësitë në lidhje me cilësinë e shërbimeve studentore. Rekomandimet e KLSH-së do të ndikojnë në nxitjen për rritjen e cilësisë së shërbimeve studentore dhe vlerësimin real të tarifave të studimit mbi bazën e analizës së kostove të tyre. Gjithashtu rekomandimet e KLSH-së do të ndikojnë në përmirësimin e veprimtarisë së drejtuesve të lartë të këtyre institucioneve, për zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

### **2.6.3 Forma e publikimit**

Në përfundim të auditimit do të përgatitet Projekt-Raporti i Auditimit, i cili iu dërgohet subjekteve publike të përfshira në auditim. Mbi këtë bazë dhe diskutimeve interaktive me subjektet publike të audituara, mbi opinionet e shfaqura prej tyre, përgatitet Raporti Përfundimtar i Auditimit, një përmbledhje e të cilit do të publikohet në Eëb-in e KLSH-së dhe rrjetet sociale të Departamentit të Auditimit të Performancës. Për rezultatet e këtij auditimi do të informohet publiku i gjerë nëpërmjet botimit të një artikulli në median e shkruar. Raporti Përfundimtar i Auditimit do të jetë pjesë analizave dhe Reportit të veprimtarisë vjetore të KLSH-së.

### 3. Kalendari dhe kosto e auditimit

#### 3.1. MATRICA E ORGANIZIMIT

Proceset e auditimit	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Në vazhdim
	02 - 31	01 27 - - 03 31	03 - 28	01 - 31	26	19	
Mbledhja e të dhënave							
Analizimi i të dhënave të grumbulluara gjatë fazës studimore							
Njohja me politikat e institucioneve në këtë fushë							
Fokusimi ndaj problemit							
Identifikimi i kritereve							
Përcaktimi i pyetjeve dhe nënpyetjeve							
Përgatitja e programit të auditimit							
Paraqitja e programit të auditimit në institucionet e përfshira në auditim							
Analizë sasiore dhe cilësore e të dhënave të mbledhura gjatë auditimit në terren							
Intervista dhe diskutime me palët e përfshira në auditim							
Analizimi i situatës aktuale të përgjegjësi, organizative, administrative dhe funksionale të IAL-ve dhe MASR:							
Hartimi i Projekt-Raportit të auditimit							
Raporti i Auditimit							
Ecuria e zbatimit të rekomandimeve nga subjekti i audituar brenda 6 muajsh pas dërgimit të raportit zyrtar							
Kontrroll i cilësisë në të ftohtë							



### 3.2. KOSTO E AUDITIMIT

Kostoja e këtij auditimi përbëhet nga paga e audituesve dhe shpenzimet për dieta sipas rastit.

### 3.3. MATRICA E KRYERJES SË AUDITIMIT SIPAS KOHËS DHE SUBJEKTEVE

Nr.	Institucioni	Muajt
1	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	Korrik – 08 Tetor 2018
2	Universiteti i Tiranës	Korrik – 08 Tetor 2018
3	Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	Korrik – 08 Tetor 2018
4	Universiteti i Korçes “ Fan Noli”,	Korrik – 08 Tetor 2018
5	Universiteti i Vlorës “Ismail Qemali”	Korrik – 08 Tetor 2018
6	Universiteti i Durrësit “Aleksandër Moisiu”	Korrik – 08 Tetor 2018
7	Universiteti “Luigj Gurakuqi”,	Korrik – 08 Tetor 2018
8	Universiteti Bujqësor i Tiranës	Korrik – 08 Tetor 2018

*Shënim:* Gjatë kësaj periudhe grupi i auditimit do të angazhohet me ditë dhe/ose javë të veçanta në subjektet nën auditim, në varësi të nevojave për realizimin me sukses të auditimit.

### 3.4. MATRICA E MARKIMIT TË PIRAMIDËS SË PYETJEVE

Nën-pyetja	Burimet e evidencës	Met. e mbl. të dhënave	Përgjegjës	Realizimi
1.1.1.	<ul style="list-style-type: none"><li>LAL 80/2015</li><li>L igji MFK Nr. 10 296</li><li>VKM nr.88, datë 14.02.18 për krijimin e RASH</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>Rishikim dhe vlerësim i dokumentacion.</li></ul>		01-08.10.18
1.1.2	<ul style="list-style-type: none"><li>VKM nr. 288, datë 21.05.18 ...kufiri max për tarifat</li><li>VKM nr.397, datë 03.05.2017 Për organizimin e AKFAL</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>Analizim i intervistave gjysmë të strukturuar pranë MASR dhe IAL-ve.</li></ul>		01-08.10.18
1.2.1.	<ul style="list-style-type: none"><li>VKM nr.75, datë 12.02.2018 ..modeli i financimit të IAL-ve</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>Pyetesor me pyetje të mbyllura dhe të hapura për studentet e IAL-ve</li></ul>		09-15.10.18
1.2.2.	<ul style="list-style-type: none"><li>Udhëzim nr.27, datë 19.12.2017 Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në IAL</li><li>Vendimet e BA të IAL-ve “Për miratimin e tarifave”</li><li>Rregulloret dhe Statutet e IAL-ve</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>Metoda krahasimore Rasti i Gjermanisë.</li><li>Analizë sasiore dhe cilësore e të dhënave të mbledhura gjatë auditimit</li></ul>		09-15.10.18

## 4. RISQET E AUDITIMIT DHE GARANTIMI I CILËSISË

### 4.1. RISQET E AUDITIMIT

Për realizimin e këtij auditimi kemi marrë në konsideratë këto risqe;

- Ngarkesa e Stafëve të IAL-ve me procesin e pranimeve të studentëve.
- Periudha kohore e papërshtateshme gjatë fazës studimore.



- Problemet organizative dhe strukturore të subjekteve nën auditim.
- Ndryshime të kompetencave dhe qarkullimi i stafit, edhe në nivel të lartë drejtues.

#### **4.2. GARANTIMI I CILËSISË**

Grupi i auditimit do të përdorë instrumentet e mëposhtme për garantimin e cilësisë:

- a) Rregulloren e Brendshme të KLSH, miratuar me Urdhrin e Kryetarit të KLSH z. Bujar Leskaj, nr. 85, datë 30.06.2015:
  - Takimi përmbyllës në subjekt duke njohur nivelin e mesëm dhe të lartë drejtues me gjetjet kryesore të auditimit;
  - Projekt-raporti i auditimit, i përgatitur nën kujdesin e përgjegjësit të grupit të auditimit, i kalohet për rishikim kryeaudituesit;
  - Grupi i auditimit, pasi reflekton sugjerimet e kryeaudituesit, ia përcjell Projekt-raportin drejtorit të departamentit;
  - Pasi pasqyrohen vërejtjet e drejtorit të departamentit nga grupi i auditimit, Projekt-raporti ju dërgohet subjekteve të audituar;
  - Mbi bazën e shqyrtimit të observacioneve të subjektit të audituar për Projekt-raportin, përgatitet Raporti Përfundimtar i Auditimit;
  - Nëse kërkohet, organizohet takimi ballafaques me subjektin e audituar;
  - Raporti Përfundimtar i Auditimit i paraqitet kryeaudituesit dhe drejtorit të departamentit, i cili kur gjykon se ky Raport është hartuar në përputhje me të gjitha kërkesat dhe detyrat e parashikuara, ia paraqet për mendim drejtorit të drejtorisë juridike dhe kontrollit të cilësisë;
  - Drejtori i drejtorisë juridike dhe zbatimit të standardeve, pasi e studion raportin dhe projekt-vendimin, ia përcjell drejtorit të departamentit të auditimit me vlerësimin përkatës;
  - Drejtori i departamentit, i cili pasi reflekton në Raportin Përfundimtar dhe Projekt-vendim, së bashku me mendimin e tij ia paraqet Kryetarit të KLSH, për vendim-marrje;
  - Në secilën fazë të auditimit, me urdhër të Kryetarit të KLSH, duke angazhuar kualitetet më të mira audituese, mund të kryhet auditimi në të ftohtë.
  - KLSH ndjek nivelin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna për subjektin e audituar.
- b) Zbatimi i “Udhëzuesi i auditimit të performancës ISSAI 3000-3100”;
- c) Zbatimi i “Manuali i Departamentit të Auditimit të Performancës”, miratuar me Urdhrin e Kryetarit të KLSH, z. Bujar Leskaj, nr. 47, datë 30.04.2015.
- d) Përdorimi “Indikatorë të performancës”, miratuar me Urdhrin e Kryetarit të KLSH, z. Bujar Leskaj, Nr. 48, datë 30.04.2015.

#### **e) GRUPI I PUNËS DHE PËRGJEGJËSITË HIERARKIKE**

Grupi i punës:

1. përgjegjës grupi, drejtor i departamentit;
2. anëtar grupi, auditues i lartë;
3. anëtar grupi, auditues i dytë.